



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI**

Adresa: Blv. "Bajram Curri" Tirana, Albania, Tel/Fax. +355 4 362937 - www.moh.gov.al

Nr. 4927 prot.

Tiranë, më 28 12.2009

UDHËZIM

Nr. 731, Date 28.12.2009

**MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TE
PROCEDURAVE TE PERQENDRUARA TE PROKURIMIT PUBLIK NE
SHERBIMIN SPITALOR NË REPUBLIKEN E SHQIPERISE**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, te nenit 11 te Ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar si dhe te Pikes 2 , Kreu I te VKM nr. 1 date 10.01.2007 "Per rregullat e prokurimit publik", te ndryshuar, me qëllim standartizimin, rritjen e eficencës dhe efikasitetit ne perdorimin e fondeve publike,

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e mënyrës se organizimit te prokurimeve te perqendruara nga institucionet spitalore publike ne Republiken e Shqiperise per medikamente dhe materiale mjekimi.
2. Përkufizime:
 - 2.1.1 "Spital publik" eshte person juridik publik me buxhet te pavarur me cilesine e autoritetit kontraktor pergjegjes per realizimin e prokurimeve publike te tij dhe qe e ushtron veprimtarine e tij ne mjediset dhe me pajisjet qe jane prone e Ministrise se Shendetesise.
 - 2.1.2 "Organ qendror bleres"-OQB eshte autoriteti kontraktor i cili:
 - a.siguron per autoritetet kontraktore mallra dhe/ose sherbime;
 - b.perzgjedh fituesit per kontratat publike per pune, mallra ose sherbime, te caktuara nga autoritetet kontraktore.

2.1.3 "Autoritet kontraktor" eshte cdo ent qe i nenshtrohen Ligjit te Prokurimit Publik per zbatimin e kontratave te tij publike.

3. Blerja e perqendruar e mallrave te njejta sipas kategorizimit te meposhtem, i ngarkohet spitaleve te cilet veprojne si organ qendror bleres, ne emer te autoriteteve kontraktore specifikuar sipas aneksit 1 te ketij udhezimi.

3.1 Spitalet qe do te veprojne si organ qendror bleres, do te prokurojne fondet ne emer dhe per llogari te tyre dhe te spitaleve ne nivel bashkie (rrethi) te percaktuara sipas aneksit 1 te ketij udhezimi per:

a) Furnizimin e spitaleve me medikamente dhe

b) Furnizimin e spitaleve me materiale konsumi me perdorim mjekesor (materiale mjekesore, materiale konsumi per laboratoret, gazra mjekesore).

3.2 Per kontratat me vlere vjetore nen 400 000 leke pa TVSH, autoritetet kontraktore duhet te zhvillojne vete procedurat ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

4. Autoritetet kontraktore duhet te dergojne prane organit qendror bleres specifikimet teknike, sasite e mallrave, qe do te prokurohen dhe fondet ne dispozicion brenda dates **15 Janar** te cdo viti.

5. Autoriteti kontraktor qe ve ne dispozicion fondet eshte pergjegjes edhe per nenshkrimin e kontrates dhe ndjekjen e saj sipas percaktimeve ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik ne fuqi .

6. Organi qendror bleres eshte plotesisht pergjegjes per kryerjen e te gjitha procedures se prokurimit qe nga njoftimi i kontrates deri ne botimin e njoftimit te shpalljes se fituesit sipas percaktimeve ne rregullat e prokurimit publik ne fuqi .

7. Organi qendror bleres shqyrton dhe miraton specifikimet teknike te derguara nga autoritetet kontraktore sipas percaktimeve ne rregullat e prokurimit publik ne fuqi.

8.1 Nese organi qendror bleres gjykon se specifikimet teknike nuk jane pergatitur ne perputhje me Ligjin per Prokurimin Publik ose se mund te shkaktojne deshtim te procedures se prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre.

8.2 Per mallra dhe sherbime te te njejtit lloj, organi qendror bleres bashkerendon punen me specialiste te fushes te institucioneve pergjegjese si dhe me specialiste te jashtem, vendas ose te huaj per unifikimin e specifikimeve teknike ne perputhje me standartet.

8.3 Nese autoritetet kontraktore ne percaktimin e te dhenave sasiore kane marre per baze cmimet te ndryshme, per mallra dhe sherbime te te

njejtit lloj, organi qendror bleres bashkerendon punen per testimin e tregut dhe perlogarit te dhenat sasiore sipas fondit te vene ne dispozicion.

8.4 Organi qendror bleres mund te kerkoje ne cdo faze te prokurimit, ndihmen e autoritetit kontraktor, si dhe t'i siguroje ketij te fundit, sa here qe i kerkohet , akses te plote per cdo informacion per proceduren e prokurimit.

9. Lista me emrat e medikamenteve dhe materialeve te konsumit per perdorim mjekesor qe do te perdoren ne sistemin spitalor publik, pergatitet nga Ministria e Shendetesise mbeshtetur ne standartet e percaktuara prej saj.

Lista themelore eshte e unifikuuar per spitalet e te gjitha niveleve. Cdo spital, ne varesi te statusit dhe sherbimeve qe ofron, percakton numrin dhe llojin e artikujve qe do te perdore nga kjo liste themelore duke i'u referuar numrit te shtreterve dhe burimeve financiare qe ka ne dispozicion.

9.1 Lista e medikamenteve dhe materialeve te konsumit per perdorim mjekesor, miratohet nga Ministri i Shendetesise dhe dergohet prane institucioneve shendetesore, jo me vone se data **31 Dhjetor** te vitit paraardhes.

9.2 Cdo institucion, ne perputhje me nevojat dhe te fondeve te vena ne dispozicion, percakton sasite per secilin artikull te percaktuar ne listen e Ministrise se Shendetesise si dhe fondin limit per secilin prej tyre.

9.3 Pas percaktimit te sasive dhe fondit limit, autoritetet kontraktore duhet te dergojne, jo me vone se data **15 Janar** , prane organit qendror bleres perkates, listat e detajuara me sasite per cdo artikull, fondin limit, si dhe kushtet dhe afatet e levrimit te ketyre mallrave.

9.4 Organi qendror bleres, prokuron fondin limit, te llogaritur si shume e fondeve, te derguara dhe miratuara nga cdo autoritet kontraktor.

9.5 Organi qendror bleres, duhet te beje publikimin njoftimit te kontrates per procedurat e perqendruara, jo me vone se data **30 mars**.

9.6 Prokurimi i nje artikulli i cili nuk perfshihet ne listen themelore miratuar sipas pikes 9.1, do te behet vetem me miratim te vecante te Ministrit te Shendetesise.

10. Autoritetet kontraktore (perfshihen ketu edhe organet qendrore blerese per fondet qe disponojne), duhet te pergatisin dhe dergojne brenda afateve te percaktuara ne rregullat e prokurimit publik, regjistrin e parashikimeve te prokurimeve publike prane institucioneve qendrore qe kane vene ne dispozicion fondet, si dhe shpalljen sa me pare te procedurave te prokurimit.

10.1 Per te gjitha fondet qe financohen nga Ministria e Shendetesise regjistri i parashikimeve te prokurimeve publike, duhet te dergohet prane Drejtorise se Prokurimeve ne Ministrine e Shendetesise. Nje kopje te permbledhur te regjistrit te parashikimeve te prokurimeve publike, Ministria e Shendetesise, ja dergon Agjencise se Prokurimit Publik dhe Deges se Thesarit ne Ministrine e Financave.

10.2 Per fondet e financuara nga Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor (ISKSH), regjistri i parashikimeve te prokurimeve publike, i miratuar nga institucionet shendetesore i dergohet ISKSH-se dhe ky i fundit dergon nje permbledhje te ketij regjistri, ne Agjencine e Prokurimit Publik dhe Ministrine e Financave. Nje kopje e ketij regjistri nga institucionet, i dergohet edhe Ministrise se Shendetesise.

11. Te gjitha autoritet kontraktore duhet te dorezojne ne organet qendrore qe vene ne dispozicion fondet si dhe prane Ministrise se Shendetesise nje informacion te hollesishem per veprimtarite e realizuara te prokurimit sipas afateve dhe percaktimeve ne Rregullat e Prokurimit Publik.

12. Organet qendrore blerese, duhet te marrin masa per realizimin e prokurimeve te perqendruara brenda afateve ligjore.

13. Zhvillimi i procedurave te perqendruara te prokurimit publik nga organet qendrore blerese dhe lidhja e kontratave nga autoritetet kontraktore behet ne perputhje me LPP, akteve nenligjore ne zbatim te tij si dhe udhezimeve te APP-se.

13.1 Organet qendrore blerese si dhe cdo autoritet kontraktor duhet te raportojne prane Ministrise se Shendetesise brenda dates 15 te cdo muaji mbi realizimin dhe ecurine e procedurave te prokurimit me objekt furnizimin e spitaleve me medikamente dhe materiale mjekimi.

14. Ngarkohen me detyrën e zbatimit të këtij udhëzimi Autoritetet Kontraktore dhe Organet Qendrore Blerese ne kuptim te ketij udhezimi.

15. Udhézimi Nr.83 date 09.02.2009 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjehere.



ANKESI 1

Organet Qendrore Bleres

1		Spitali Rajonal Berat- OQB
1	Spitali	Berat
2	Spitali	Skrapar
3	Spitali	Kucove
2		Spitali Rajonal Peshkopi-OQB
1	Spitali	Peshkopi
2	Spitali	Bulqize
3	Spitali	Bureli (Mat)
3		Spitali Rajonal Elbasan-OQB
1	Spitali	Elbasan
2	Spitali	Psikiatrik Elbasan
3	Spitali	Gramsh
4	Spitali	Librazhd
5	Spitali	Peqin
4		Spitali Rajonal Fier-OQB
1	Spitali	Fier
2	Spitali	Ballsh (Mallakaster)
5		Spitali Rajonal Gjirokaster-OQB
1	Spitali	Gjirokaster
2	Spitali	Permet
3	Spitali	Tepelene
6		Spitali Rajonal Korce-OQB
1	Spitali	Korce
2	Spitali	Bilisht (Devoll)
3	Spitali	Erseke (Kolonje)
4	Spitali	Pogradec
7		Spitali Rajonal Kukës-OQB
1	Spitali	Kukës
2	Spitali	Has
3	Spitali	Bajram Curri (Tropoje)
8		Spitali Rajonal Lezhe-OQB
1	Spitali	Lezhe
2	Spitali	Lac
3	Spitali	Rreshen (Mirdite)
9		Spitali Rajonal Shkoder-OQB
1	Spitali	Shkoder
2	Spitali	Malesi e Madhe
3	Spitali	Puke
4	Spitali	Psikiatrik Shkoder
10		Spitali Rajonal Vlore-OQB
1	Spitali	Vlore
2	Spitali	Psikiatrik Vlore

11		Spitali Rajonal Durres-OQB
1	Spitali	Durres
2	Spitali	Kavaje
3	Spitali	Kruje
12		Spitali Sarande-OQB
3	Spitali	Sarande
4	Spitali	Delvine